

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Ardian Ajvazi dhe procesmbajtesja Valmira Sejdiu, në çështjen juridike kontestimore të inicuar me padinë e paditëses [REDAKTUAR] me seli në Prishtinë, kundër të paditurit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR]-Ferizaj, baza e kontestit rimbursimi i dëmit, jashtë seance me date 14.10.2015, merr këtë:

A K T G J Y K I M

-PËR SHKAK TË PADËGJUESHMËRISË/MOSBINDJES-

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses [REDAKTUAR] me seli në Prishtinë, si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR]-Ferizaj, që paditëses t'ia kompensojë shumën prej **510.00 Euro (pesëqindë e dhjetë Euro)**, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 19.06.2011 në Ferizaj, së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeqare pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë 03.11.2013 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi e nën kërkëcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjyaktë ka ushtruar padi me datë 03.11.2013, kundër të paditurit, për rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 19.06.2011 në Ferizaj në shumën prej 51.00 Euro dhe ka kërkuar që e njehta të aprovohet në tërësi si e bazuar. I padituri me datën 19.06.2011 rreth orës 14:00, me automjetin Mercedes me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] ka shkaktuar aksidet trafiku në Ferizaj dhe e ka goditur automjetin Scooter Motoçikletë pronë e [REDAKTUAR]. I padituri ka qenë i pasiguruar, pra kishte afat të skaduar të regjistrimit. Në ndërkohë I dëmtuari ka parashtruar kërkesë tek BKS për kompenzim të dëmit dhe sipas Ligjit nr.04/L-018 Pr Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, BKS është detyruar që këtë dëm t'ia kompenzojë të dëmtuarit dhe të njejtin dëm kërkon ta rimbursoj nga shkaktari i aksidentit.

Të paditurit Gjykata i ka dërguar aktvendim për përgjegje në padi së bashku me shkresat e lëndës, i cili fakt konstatohet në bazë të fletlthesës se e ka pranuar me datë 26.09.2015, por i padituri [REDAKTUAR] në afatit të përcaktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi nuk ka dhënë përgjigje në padi, nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa Gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si duke patur parasysh faktin se i padituri ka pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata bazuar në nenin 150.6 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjyqjësë. I padituri ka qenë i detyruar që mbrenda afatit 15 ditësh pas pranimit të të njejtit të jep përgjegje për pretendimet e paditëses, por të njejtin afat e ka leshuar dhe nuk ka dhënë përgjigje dhe deri me sot kanë kaluar 17 ditë.

Paditësja, Gjykatës i ka bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera materiale për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar në shumën prej 510.00 Euro.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur ne bazë të nenit 378 të LMD-së.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve te procedures kontestimore në bazë të nenit 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.683/13, me datë 14.10.2015

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana 26.11 2018

Gjyqtari,

Ardian Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme nga pranimit i këtij Aktgjykimi.